


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 3048/16 Vendimi

V E N D I M
“I GJYQTARIT TE VETEM”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga:

Gjyqtar: KASTRIOT GRAMSHI

Sot më datë **25/05/2015** si gjyqtar i vetem mora në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, kerkesen që i përket:

KERKUES: **Aranita Brahaj**, e bija e Jahos, dtl 11.04.1977, lindur në Pukë e banuese në Tiranë, Lagjia «Ali Demi», Rr. «Shemsi Haka», Pall. 73/2.

OBJEKTI: Depozitim në Rregjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të Vendimit dt. 31.03.2015 të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtareve të Shoqates “**Instituti Shqipetar i Shkencave**” pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr 8789 dt 07.05.2001; Ligji Nr 8788 dt 07.05.2001

Nga shqyrtimi i kësaj kërkesë, Gjykata pasi analizoi dokumentacionin në tërësi,

VËREN:

Se, kërkesja Aranita Brahaj, me kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kërkuar depozitim në Rregjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Vendimit date 31.03.2015 të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtareve të Shoqates “Instituti Shqipetar i Shkencave” pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Ne seance gjyqësore rezultoi se shoqata “Instituti Shqipetar i Shkencave” është e regjistruar si person juridik me vendimin nr.3048, date 27.07.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, me kryetare Aranita Brahaj.

Rezultoi se në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtareve të shoqates “Instituti Shqipetar i Shkencave” me vendimin e datës 31.03.2015 është vendosur:

- Ndryshimi i Adresës së Organizatës nga ajo:- Rr. “Hodo Beg”, Pall 12-Katesh, Apt. 24, Tiranë bëhet Rr. “Asim Vokshi”, Pallati 13/25, Kat 3. Tiranë.
- Shtesë e Statutit me një parashikimin si vijon: Drejtori Ekzekutiv, përmes akteve noteriale të tipit Prokurë e Posaçme, ka të drejtë të autorizojë Sekretarin e Organizatës për kryerjen e veprimeve të përfaqësimit sipas specifikimeve me shkrim në aktin e nënshkruar përpara noterit. Për çdo akt noterial Prokurë e Posaçme vihet në dijeni në dijeni Mbledhja e Anëtarësisë.

Kerkesja kërkon depozitim në këtë vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtareve pranë akteve të shoqates “Instituti Shqipetar i Shkencave”, që ndodhen në Rregjistrin e Organizatave

Jofitimpruese ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në bazë të ligjit 8789, dt.07.05.2001 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese”

Kërkesa është e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Në bazë të ligjit 8788, dt.7.05.2001 “Për organizatat jofitimpruese” dhe ligjit 8789, date 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”,

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitim në regjistrin e OJQ-ve të vendimit të datës 31.03.2015 ku është vendosur :
 - Ndryshimi i Adresës së Organizatës nga ajo:- Rr. “Hodo Beg”, Pall 12-Katesh, Apt. 24, Tiranë bëhet në Rr. “Asim Vokshi”, Pallati 13/25, Kat 3. Tiranë.
 - Shtesë e Statutit me një parashikimin si vijon: Drejtori Ekzekutiv, përmes akteve noteriale të tipit Prokurë e Posaçme, ka të drejtë të autorizojë Sekretarin e Organizatës për kryerjen e veprimeve të përfaqësimit sipas specifikimeve me shkrim në aktin e nënshkruar përpara noterit. Për çdo akt noterial Prokurë e Posaçme vihet në dijeni në dijeni Mbledhja e Anëtarësisë.
- Të behen shenimet perkatese në regjistrin e Organizatave Jofitimpruese pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Ky vendim është i formës së prere.

U Shpall sot me datë 25/05/2015

GJYQTARI

KASTRIOT GRAMSHI

